



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CML.nr.1/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mr.sc.Muhamet Rexha, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nenad Lazić, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit R. B., me seli në P., kundër debitorës B. S. nga fshati ..., i V., lidhur me pagesën e borxhit në emër të kredisë, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, CPP.nr.412/2020 të datës 24.06.2020 dhe aktvendimit të Gjykatës Apelit të Kosovës Ac.nr.5278/2020, datë 24.09.2021, në seancën e mbajtur më datë 12.04.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, CPP.nr.412/2020 të datës 24.06.2020 dhe aktvendimit të Gjykatës Apelit të Kosovës Ac.nr.5278/2020, datë 24.09.2021.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, CPP.nr.412/2020 të datës 24.06.2020, aprovohet kundërshtimi i debitorit B. S. nga fshati ..., dhe anulohet aktvendimi për lejimin e përmbartimit CP.nr.30/2014 i datës 27.08.2015.

Në procedurën sipas ankesës së paraqitur nga kreditori, Gjykata e Apelit, me aktvendimin Ac.nr.5278/2020, datë 24.09.2021, e aprovon si të themeltë ankesën e kreditorit R. B. me seli në P., e ndryshon aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Dega në Vushtrri, Departamenti

i Përgjithshëm, CPP.nr.412/20, i datës 24.06.2020 ashtu që tani gjykon si vijon: Refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitores B. S. nga fshati ..., Komuna V. dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Dega në Vushtrri, CP.nr.30/14, i datës 27.08.2015 me të cilin është lejuar përmbarimi i propozuar mbetet në fuqi.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Prokurori i Shtetit me kohë ka paraqitë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 247 paragrafi 1, pika a) të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK).

Në kuptim të dispozitës së nenit 250 të LPK-së, gjykata ka caktuar seancën dëgjimore për të cilën janë njoftuar Prokurori i Shtetit dhe palët ndërgjyqësore. Prezent ishin vetëm përfaqësuesi i kreditorit, ndërsa mungonte Prokurori i Shtetit i cili ishte ftuar në mënyrë të rregullt dhe debitori, gjegjësisht incuesja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sepse nga flet kthesa e postës rekomande R-2268609, konstatohet se e njëjta është shpërngulur dhe nuk e ka njoftuar gjykatën me adresën e re.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 251 të LPK-së, shqyrtoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe gjeti se:

Kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pa mbështetura në ligj, nga shkakut se pretendimet e debitores, si inicuese për mjet të jashtëzakonshëm juridik janë të bazuara, sepse lidhur me të njëjtën çështje përmbarimore, bazuar në Konkluzionin e Gjykatës Themelore në Prishtinë E.nr.1842/13 të datës 01.12.2021, është duke u zhvilluar procedura përmbarimore të përmbaruesi privat S. R., ndaj debitores L. P., e cila në rastin konkret është debitorja e parë për nga radha, si kredi marrëse dhe garantuesve tjerë, ku njëra ndër garantueset është edhe debitorja B. S., andaj lejimi i përmbarimit në këtë fazë do të ishte në kundërshtim me parimin e ekonomizimit të procedurës dhe mund të krijonte një precedentë që do të hapte rrugë të

panevojshme për çështje të njëjta. Nga sa u tha më sipër konsideroj se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet nga Gjykata Supreme në mënyrë që të evitohet situata ku për të njëjtën çështje përmbartimore të merren disa vendime, të cilat mund të jenë të ndryshme dhe mund të dërgojnë në hapjen e pa nevojshme edhe të çështjeve tjera procedurale.

Objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në rastin konkret është aktvendimi me të cilin gjykata e shkallës së parë e kishte aprovuar kundërshtimin dhe e kishte anuluar aktvendimin për lejimin e përmbartimit CP.nr.30/14 të datës 27.08.2015, si dhe Aktvendimi me të cilin Gjykata e Apelit e aprovon si të themeltë, ankesën e kreditorit dhe e ndryshon aktvendimin e shkallës së parë duke e refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorës dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Dega në Vushtrri, CP.nr.30/14, i datës 27.08.2015, me të cilin është lejuar përmbartimi i propozuar mbetet në fuqi.

Prokurori i shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, nuk është thirrur në asnjë shkelje konkrete të dispozitave materiale apo procedurale, përveç faktit se kreditori ka bërë kërkesë për përmbartim ndaj kredi marrëses së parë L. P., E.nr.1842/13 të datës 01.12.2021, dhe se kjo sipas Prokurorit të Shtetit është në kundërshtim me parimin e ekonomizimit të procedurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shteti, mbështetet në pretendime të natyrës së tillë për të cilat kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kryesisht është e kufizuar, prandaj edhe vlerësohen si pretendime të pathemelta.

Me dispozitën e nenit 247 paragrafi 1, përcaktohet se: “ *Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë: a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale”.*

Bazuar në shkresat e lëndës vërtetohet se debitori me kreditorin më datë 07.12. 2011, kanë lidhur kontratë mbi kredi personale, ku debitori ka qenë në cilësinë e garantuesit, ndërsa kredi marrës ka qenë L. P., , shuma e kredisë ka qenë 15,200.00€. Me nenin 5 të kontratës në fjalë, debitori është pajtuar që sigurimi i kredisë nga kredi marrësi të garantojnë me tërë pasurinë që e kanë në pronësi dhe ose posedim si dhe mjetet që gjenden në llogaritë e tyre bankare. Qëndrimi i Gjykatës së Apelit se përcaktues për këtë çështje është neni 11 i kontratës i cili ka përcaktuar raportin mes debitorit dhe kredi marrësit si dhe garantuesit tjetër (personit të tretë) se do të jetë në formën e përgjegjësisë solidare. *“Bashkë Kredi marrësi/Garantuesi kanë përgjegjësi solidare për përmbushjen e plotë të kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshje. Në rast se kredi marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij sipas afateve të parapara me këtë Marrëveshje, nuk do të kërkohet nga Kredi dhënësi të realizoj ndonjë të drejtë apo kompensim ose të marr ndonjë veprim ligjor kundër kredi marrësit ose ndonjë personi, entiteti apo kolaterali tjetër, para se të kërkoj nga Bashkë kredi marrësi/garantuesi ta korrigjoj shkeljen e marrëveshjes”,* ndërsa në paragrafin 2 përcaktohet: Bashkë Kredi marrësi- Garantuesi apo kolaterali tjetër, para se të kërkoj nga Bashkë kredi marrësi/garantuesi ta korrigjoj shkeljen e Marrëveshjes, ndërsa në paragrafin 2 përcaktohet: *“ bashkë-kredi marrësi/Garantuesi e autorizon Bankën që të ngarkoj llogarinë e tij tek kredi dhënësi me numër si dhe në llogaritë që ka në Bankat tjera të cilat janë në emër të tij, pa i dhënë njoftim paraprak garantuesit, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të garantuesit si është përshkruar në këtë Marrëveshje bashkë-Kredi marrësi/garantuesi nuk do të kontestoj ose kundërshtoj çfarëdo ngarkese të llogarisë në bazë të këtij neni”.*

Për më tepër me nenin 10 të Marrëveshjes së cituar më lartë parashihen të drejtat dhe kompensimet e Kredi dhënësit, e të cilat nuk kufizohen vetëm në ato të cekura në mënyrë taksative, ku ndër këto të drejta parashihen: " d) të hyjë në objektet e Kredi marrësit, Bashkë kredi marrësit dhe Garantuesit të marrë e të shesë ndonjë apo gjithë kolateralin ose në mënyra tjera të sigurimit të përcaktuara me nenin 5 dhe pikën 1, II të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshje, e) të Bllokojë të gjitha llogaritë e Kredi marrësit, bashkë-Kredi marrësit dhe Garantuesit dhe njëkohësisht të tërheq mjetet/të hollat nga të gjitha llogaritë me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të Kredi marrësit/Bashkë Kredi marrësit / Garantuesit të specifikuara me këtë Marrëveshje".

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon në tërësi qëndrimin e Gjykatës së Apelit duke u nisur nga fakti se edhe sipas përcaktimit të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Rregullores për Regjistrin e kredive, e nxjerr në bazë të këtij Ligji, në nenin 1.13. definohet se "Bashkë-kredi marrës - nënkupton një person fizik ose një entitet juridik i cili merr përsipër një detyrim kreditor me një person fizik ose një entitet juridik tjetër ndërsa në nenin 1.14. përcaktohet se Garantues- nënkupton një person fizik ose entitet juridik i cili merr përsipër detyrimin ligjor të kthimit të kredisë në rast të dështimit të kthimit të kredisë nga kredi marrësi parësor. Pra me nënshkrimin e marrëveshjes mbi kredinë, secila palë nënshkruese duke përfshirë edhe debitoren, ka qenë e njoftuar me detyrimet që i merr dhe me autorizimet që ia bartë tani kreditorit si kredi dhënës. Në rastin konkret palët janë pajtuar që përveç kredi marrësit dhe garantuesit të kenë përgjegjësi solidarë për përmbushjen e marrëveshjes dhe është në vullnetin e kreditorit se nga cili prej garantuesve solidarë do ta kërkoj realizimin e kredisë.

Lidhur me pretendimin e Prokurorit të Shtetit se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është duke u zhvilluar procedura përmbareme te përmbaremi privat S. R., ndaj debitorës L. P., e cila në rastin konkret është debitorja e parë për nga radha, si kredi marrëse dhe garantuesve tjerë, ku njëra ndër garantueset është edhe debitorja B. S., dhe se kjo bie ndesh me parimin e ekonomizimit të procedurës, Gjykata Supreme e Kosovës nuk e aprovoi si të ligjshëm këtë pretendim për faktin se Kreditori me parashtrësën e datës 14.03.2021, ka njoftuar Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ka kërkuar tërheqjen e propozimit për përmbaremi ndaj debitorës B. S., duke e cekur gjyq vartësinë me rastin që udhëhiqet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, ku është edhe vendbanimi i përhershëm i debitorës dhe ku procedura është në fazën më të avancuar. Kompetenca territoriale përcaktohet me nenin 76.4 të Ligji nr. 03/L-008 Për Procedurën përmbareme, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: nr. 33 / 15 korrik 2008, i cili ka qenë në fuqi, në kohën e inicimit të procedurës përmbareme ku parashihet se "Për vendosje për propozimin e kompetencës territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit, e nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i tij, kur kemi të bëjmë me personin fizik."

Përfundimisht, të drejtën për të kërkuar përmbushjen e marrëveshjes nga secili prej debitorëve, kreditori e ka mbi bazën e vet marrëveshjes e cila nuk u gjet se është lidhur në

kundërshtim me ligjin. Me dispozitën e nenit 22 pika 1.7 të LPP-së është paraparë se dokument përmbarimor është edhe kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit dhe rrjedhimisht nuk ekziston asnjë pengesë ligjore që do të parasheh pezullimin e ekzekutimit të përmbarimit. Në këtë rast Gjykata Supreme pretendimin e debitorit për shkeljen e referuar e ka vlerësuar në frymën e dispozitave të cituara të LPP-së, por duke marrë në konsideratë specifikat e procedurës përmbarimore, nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit por edhe pretendimet për shkeljet në fazën e zbatimit të përmbarimit.

Për arsyet e sipër theksuara me lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 245 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

CML.nr. 1/2022, më datë 12.04.2022.

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha